



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 22 Prill 2021

Nr: 30

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 20, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 22.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Aleanca Demokracia e Re.

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 20, të partisë Aleanca Demokracia e Re me objekt 1. Kundërshtimin e vendimit datë 21.04.2021, të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 41, qarku Tiranë. 2. Ndryshimin e vendimit datë 21.04.2021 të KZAZ nr. 41 dhe pranimin e listës së vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



## VËREN:

Subjekti ankues partia Aleanca Demokracia e Re ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 20 regj., datë 22.04.2021.

Në mbledhjen e datës 22.04.2021, ora 18:30, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr. 20 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 20, datë 22.04.2021, të paraqitur nga partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23 Prill 2021, në orën 11:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjan RUSMALI - Relator**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**

